



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 667/3 Prot.

Tiranë, më 28 . 06 . 2022

V E N D I M

Nr. 129, Datë 28 . 06 . 2022

Mbështetur në nenin 32, pika 1, shkronja a), të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*¹”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi² mori në shqyrtim ankesën me nr.70 Regj., datë 26.04.2022, të shtetases E. Z, kundër Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas³, me pretendimin e diskriminimit për “*çdo shkak tjetër*⁴”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi⁵,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Në parashtrimet e sjella pranë Komisionerit, subjekti ankues, E. Z, ka shpjeguar se prej 16 muajsh mban pozicionin “Specialiste”, pranë Drejtorisë së Mbikëqyrjes së Standardeve të Ofrimit të Shërbimit të Ndihmës Juridike, në Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas.

Subjekti ankues ka pretenduar se është diskriminuar nga ana e punëdhënësit gjatë marrëdhënieve të punës, duke u vënë në pozita të pafavorshme e të padrejta, duke renditur kronologjikisht disa momente specifike dhe duke shpjeguar se është diskriminuar për shkak se ajo ka informuar organin epror të punëdhënësit (Ministrinë e Drejtësisë) lidhur me paligjshmëritë e konstatuara prej saj në veprimtarinë e institucionit ku punon.

¹ Në vijim do t’i referohemi me akronimin LMD.

² Në vijim do t’i referohemi me akronimin KMD ose Komisioneri.

³ Titullarit të Institucionit E. Q dhe eprorit direkt, R. K.

⁴ Subjekti ankues referon tek ky shkak denoncimin që ka bërë në Ministrinë e Drejtësisë lidhur me paligjshmëritë e punëdhënësit.

⁵ Në vijim do t’i referohemi me akronimin KMD ose si Komisioneri.

Ankuesja ka pretenduar se prej 6 muajsh diskriminohet nga eprorët e saj z. Q dhe z. K, të cilët në mënyrë të vazhdueshme e kanë vendosur atë në situata të pafavorshme pune. Ankuesja, ndër të tjera, shprehet se:

“Me dy eprorët e mi, jam që prej muajit nëntor 2021 në një marrëdhënie diskriminimi, konfliktuale. Ata në mënyrë të vazhdueshme më kanë vendosur në situata të pafavorshme pune, duke mos më krijuar mundësinë e mjeteve minimale të punës dhe ngrohjes, duke më mbingarkuar me detyra, pasi Drejtoria ku unë punoj është minimalisht prej 6 muajsh me tri vende vakante në strukturë, si dhe nga ana e eprorëve është proceduar në shumë raste me akte administrative të paligjshme, urdhëra që bien ndesh me ligjin, për të cilat konform ligjit kam njoftuar eprorin e eprorit lidhur me këtë akt, Ministrin e Drejtësisë.

...Ndaj meje në mënyrë diskriminuese më është refuzuar tri herë radhazi leja vjetore, pa shkaqe të përligjura ose pengesa të krijuara artificialisht, më pengohet e drejta e ngritjes në detyrë dhe sugjestionohet mbi këtë fakt. Mendoj se ky diskriminim dhe presion vjen për faktin se kam kundërshtuar urdhërat e paligjshëm të eprorit, si p.sh. në rastin kur kam kundërshtuar urdhërin për ngritjen e grupit të punës për një vlerësim pagash, si një urdhër jo i ligjshëm, i cili binte ndesh me aktet ligjore (ku unë isha caktuar si anëtare e Komisionit të prokurimit). Për këto arsye i jam drejtuar eprorëve në Ministrinë e Drejtësisë duke kërkuar marrjen e masave për vendosjen e legjitimitetit, si dhe shfuqizimin e akteve administrative kur ka qenë rasti, në rastet kur eprori nuk ka revokuar vetë aktin. Situata me eprorët e mi është përkeqësuar edhe më tepër, kur kërkesa ime për lejen zyrtare të vitit 2021, u refuzua tri herë pa shkak, deri në miratimin e saj pas ankesës zyrtare që bëra në Ministrinë e Drejtësisë (MD), pasi eprorit tim iu kërkuua nga eprorët e Ministrisë zbatimi i ligjit.

Eprorët e mi qëllimisht nuk kanë plotësuar stafin duke lënë Drejtorinë ku unë jam e emëruar me tre specialistë mangut në strukturë, Drejtori e cila ka një fluks pune jashtëzakonisht të lartë.

...Rrethana e fundit diskriminuese është marrja e masës disiplinore “Vërejtje”, e datës 20.04.2022, (me motivacionin e largimit të punonjësit nga ambientet e institucionit gjatë orarit zyrtar pa lejen e eprorit direkt), kur shkova në MD, e cila ishte diskriminuese pasi në ditën e marrjes së masës, edhe specialistë të tjerë kanë lëvizur nga ambientet e punës, por edhe për shkakun që eprori më kishte dhënë leje për këtë takim në MD. Ky veprim më vinte në situatë të pafavorshme duke mos më lejuar mundësinë e ankesave ndaj eprorit tim. Për këtë i kërkoja të marrë masa disiplinore edhe për kolegët e tjerë, por eprori ndaj tyre nuk filloi asnjë ecuri disiplinore. Për këtë arsye, i kërkoja me e-mail zyrtar të marrë masa mbi eliminimin e diskriminimit ndaj meje. Përveç kësaj, marrja e masës shërbeu si rrethanë rënduese të gjendjes time psikologjike për procedurën e ngritjes në detyrë (thirrja 3985 pranë DAP-it) ku kam marrë pjesë në provim, megjithë dhunën e diskriminimit e mundshëm që mund t'i ushtrohet një nëpunësi civil, dhe dëshirës për ta përfunduar me ngut këtë detyrë.

Nuk më është vënë në dispozicion asnjë procesverbal i mbajtur me datë 08.04.2022, ku konstatohej mungesa ime në punë. Në mungesë të plotë dijenie të këtij fakti, i kërkoj titullarit të Institucionit një vërtetim fakti që nuk kam masë disiplinore në fuqi, me qëllim për t'u kualifikuar për konkurimin në shpalljen 3985, Përgjegjës i Sektorit të Monitorimit të Veprimtarisë Përmbartimore Gjyqësore Private/Drejtoria e Monitorimit të Profesioneve të Lira, në Drejtorinë

e Përgjithshme Rregullatore të Çështjeve të Drejtësisë, në Ministrinë e Drejtësisë, sektor ku kisha dhënë kontributin tim edhe më parë, si specialist i transferuar me vendim të përkohshëm”.

Ankuesja është shprehur se nga eprorët e saj kishte një refuzim për të lëshuar vërtetimin se ndaj saj se nuk kishte masa disiplinore në fuqi, dhe se me shkresën me nr. 903/3 prot., datë 12.04.2022, asaj i është njoftur shkresa me lëndë njoftimin e fillimit të ecurisë disiplinore me qëllim marrjen e masës disiplinore, për shkak se nuk ishte gjendur në ambientet e punës në datën 08.04.2022. Më tej, eprori, ka vijuar me lëshimin e vërtetimit të kërkuar nga ankuesja për DAP-in, me cilësimin se ndaj personit të saj nuk kishte masë disiplinore në fuqi, por në datën 12.04.2022 kishte filluar një ecuri për procedim disiplinor.

Lidhur me këtë cilësim të evidentuar në këtë vërtetim, ankuesja i është drejtuar titullarit të Institucionit/punëdhënësit të saj, duke i kërkuar që vërtetimi të ishte, sikurse e përcaktonte DAP-i në shpallje, lidhur me të dhënat se nuk kishte masë disiplinore në fuqi deri në datën e specifikuar nga DAP-i, pra deri me datë 12.04.2022, dhe jo të bënte një historik mbi ecuritë disiplinore që sugjestionojnë palët.

Ankuesja ka evidentuar faktin se qëllimi i eprorit ishte dashakeq lidhur me cilësimin e këtij fakti në vërtetimin e kërkuar nga DAP-i, pasi përbënte pengesë për të në procedurën e konkurimit për ngritje në detyrë, duke u shprehur se: *“Deri në datën e provimit me 20.04.2022 kur unë kërkoja me email zyrtar leje për largimin për provim, edhe pse eprorët e mi kishin stisur procedurë të ngutshme dhe të përshpjeguar për marrjen e masës në ditën e provimit, eprorët refuzonin në heshtje të më jepnin leje për të lëvizur, deri sa ky email i shkoi për dijeni edhe MD, dhe u detyruan të më jepnin konfirmimin. I gjithë ky proces, me qëllim moskonkurimin tim, është shoqëruar me ngarkesë të lartë psikologjike, dhe më ka vendosur në pozita të pafavorshme e të padrejta me konkurentët e tjerë që kanë konkuruar në të njëjtin pozicion si unë”.*

Në këtë kontekst, ankuesja ka pretenduar se për shkak se është ankuar dhe ka raportuar në Ministrinë e Drejtësisë për shkeljet dhe paligjshmëritë e punëdhënësit, nga ana e tij kundrejt saj janë ndërmarrë veprime diskriminuese, vetëm për faktin e këtyre denoncimeve.

Në përfundim, ankuesja ka kërkuar nga Komisioneri konstatimin e diskriminimit ndaj saj dhe marrjen e masave për eliminimin e këtij diskriminimi nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 1021/2010, i ndryshuar, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin*

seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si “*çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi*”.

Në bazë të nenit 7, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi, garantohet nga çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Nëpërmjet shkresës me nr. 667/1 prot., datë 05.05.2022, Komisioneri ka njoftuar dhe i ka kërkuar parashtrime, Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas (DNJF) lidhur me pretendimin e subjektit ankues.

Nëpërmjet shkresës me nr. 1093/1 prot., datë 18.05.2022, DNJF, ka dërguar pranë Komisionerit parashtrimet dhe argumentimin lidhur me qëndrimin përse i takon pretendimeve të ankueses, si dhe ka dërguar dokumentacion në cilësi prove.

Parashtrimet dhe e sjella nga DNJF, në konkluzion të tyre përmbledhin si më poshtë citohet:

“Drejtoria e Mbikëqyrjes së Standardeve të Ofrimit të Shërbimit të Ndihmës Juridike Falas, është një prej drejtorive në Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas. Drejtoria e Mbikëqyrjes në vijimësi po shënon rritje të volumit të punës, për shkak të mirëfunksionimit të mekanizmit të ndihmës juridike. Në anën tjetër, kjo rritje volumi pune është përballur me vakanca në këtë Drejtori dhe mobilitet të punonjësve. Që prej nisjes së veprimtarisë së Institucionit, kjo Drejtori nuk ka qenë asnjëherë e plotësuar me pesë specialistë dhe një drejtor, siç parashikon organigrama. Në mirëmenaxhimin e burimeve njerëzore, pranë kësaj Drejtorie kanë dhënë kontributin e tyre me detyra specifike apo me angazhim të plotë edhe specialistë të tjerë nga Drejtoria e Politikave, si I. D. dhe I. A., të cilët janë bërë pjesë e grupit të punës për shqyrtimin e vlerësimin ligjor të praktikave të pagesave të ofruesve të ndihmës juridike falas. Veprim me

qëllimin për t'i ardhur në ndihmë dy specialistëve të vetëm në Drejtorinë e Mbikëqyrjes së Standardeve, K. P. dhe ankueses, E. Z. Përballë tablosë së mësipërme, sërish ndaj ankueses ka patur një qëndrim indulgjent që me marrjen e detyrës e në vijimsi, reflektuar kjo në proporcionalitetin e masave në gabimet në trajtimin e praktikave apo dhe në tolerancat që lejon ligji në angazhimin e punonjësit dhe në përfitimin e lejeve.

....bashkëlidhur shkresës do të gjeni komunikime të znj. Z ku kërkon llogari eprorëve për punën e tyre, për punën e kolegëve, apo duke kuptuar se do të cënonte imazhin e institucionit me të tretë apo me institucionin e MD.

Znj. Z është rikthyer në pozicionin e specialistes në Drejtorinë e Standardeve të Ofrimit të Shërbimit të Ndihmës Juridike Falas me datë 24.09.2021, pas një transferimi 6 mujor në MD, dhe rikthimit në detyrë. Sjellim në vëmendje të KMD-së se, znj. Z ka qenë e ngarkuar me detyrë në MD, që nga fillimi i veprimtarisë së DNJF përgjatë viteve 2020-2021.

Për një periudhë 1 mujore, znj. Z nuk i janë ngarkuar praktika për trajtim duke i dhënë mundësinë të ambientohet në institucion dhe me vijueshmërinë e punës. Përballë këtij vullneti të mirë, sjellja e znj. Z erdhi duke u agravuar në cilësinë e kryerjes së punës, mosprezencat gjatë orarit zyrtar pa informuar e pa kërkuar leje, kërkesave për leje të shumta, sjelljes konfliktuale me eprorët. Masa e parë e marrë për punonjësen ishte heqja e ditës së punës me Urdhrin nr. 17, datë 31.01.2022, për mosparaqitje në orarin zyrtar me datë 31.01.2022, për dy punonjës: ankuesen, znj. Z dhe z. D. Kjo masë nuk ndihmoi në reflektimin e punonjësës por në agravimin e mëtejshëm që konkludoi me marrjen e masës së vërejtjes së lehtë. Kjo masë erdhi jo vetëm për nga rëndësia që kishte sjellja në fjalë, por duke marrë në konsideratë tërë sjelljen e punonjësës.

Lidhur me kërkesat për leje:

Znj. Z me datë 04.02.2022 i është drejtuar titullarit të Institucionit me kërkesë për lejen vjetore për vitin 2021. Duke qenë se punonjësja në vitin 2021 ka qenë e punësuar pranë MD-së, me transferim të përkohshëm dhe për lejen e kryer përgjatë këtij viti, institucioni nuk kishte informacion, DNJF, i është drejtuar shkresërisht MD-së, për t'u informuar për ditët e lejes së ezauruar nga znj. Zeqiraj gjatë vitit 2021.

Ky informacion ka mbërritur në institucion zyrtarisht me shkresën me nr. 333/2 prot., të datës 21.02.2022. Si rrjedhojë deri në datën 21.02.2022 nuk mund të kryhej miratimi i lejes, pasi pritej konfirmimi për lejen ende të pakryer. Në datën 22.02.2022 ankuesja ka depozituar një kërkesë tjetër për miratimin e lejes për periudhën nga data 28.02.2022-13.03.2022, ndërkohë që institucioni po angazhohej me auditimin e përgjithshëm në zbatim të Programit të auditimit me nr. 483/1 prot., datë 27.01.2022, titullari i institucionit i kishte pezulluar të gjitha lejet me qëllim që çdo punonjës t'u përgjigjej në kohë gjetjeve dhe sqarimeve që kërkonte grupi i auditimit për çdo dosje të avokatëve apo ekspertëve të caktuar nga gjykata.

Leja i është refuzuar znj. Z nga eprori i saj direkt me argumentimin se institucioni po i nënshtrohet procesit të auditimit dhe për këtë kërkohet asistencë nga i gjithë stafi. Për situata të ngjashme, për arsye të moscënimit të proceseve të punës në institucion, janë pezulluar edhe lejet për dy punonjës të tjerë, znj. P dhe znj. J . Ndërkaq, me datë 07.03.2022, në përfundim të të gjitha angazhimeve me grupin e auditimit, znj. Z i është miratuar menjëherë leja e zakonshme për periudhën 17.03.2022-30.03.2022.

Sa më sipër, theksojmë faktin se punonjësve nuk iu është cënuar e drejta për përfitimin e lejes vjetore, por koha e përfitimit të saj është planifikuar duke mos cënuar proceset e punës në institucion. Ky fakt nuk përbën diskriminim në kushtet kur dhe punonjësit e tjerë të institucionit janë trajtuar njësoj”.

Lidhur me pretendimet e ankueses për ambientin dhe mjetet e punës, DNJF, shprehet se, ky institucion që prej viti 2021 ushtron aktivitetin e saj në një ambient i cili përbëhet nga dy kate. Në katin e parë të godinës janë vendosur të gjithë punonjësit e Drejtorisë së Dytësore, pra, znj. Z nuk është e vetme në zyrë por me punonjësit e tjerë të Drejtorisë. DNJF shprehet se:

“Përsa i përket pretendimit për mjete të papërshtatshme të punës, i vetmi pretendim i saj ka qenë printeri, i cili u rregullua nga asistenca e z. SH (Specialist pranë MD). Në strukturën e DNJF mungon një punonjës IT. Për aq kohë sa kemi mungesa të punonjësve IT, ne asistohemi nga AKSH-i për çdo problem me pajisjet elektronike në institucion. Në këto kushte, në rastet kur printeri nuk punonte dhe kishte probleme, znj. Z i është krijuar mundësia të printonte në çdo zyrë tjetër që ka printer. Në korridor të institucionit gjithashtu ka një printer ku znj. Z në çdo rast me një usb mund të printonte aty.

Sa i përket pretendimeve mbi ambientin e papërshtatshëm, bashkëlidhur gjeni disa foto të zyrës ku ka qëndruar znj. Z dhe më hershëm punonjës të tjerë të Institucionit. Në këtë zyrë janë vendosur fizikisht edhe punonjës të tjerë të Drejtorisë së Mbikëqyrjes, siç duken në foto”.

Bazuar në kërkesë-padinë e ankueses drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë (në vijim Gjykatës), rezulton se pretendimi i ngritur nga E. Z për diskriminim në marrëdhëniet e punës, është bërë objekt i shqyrtimit gjyqësor.

Theksojmë se, të njëjtat fakte dhe rrethana janë paraqitur edhe përpara Komisionerit. Po ashtu i njëjti shkak që bëhet prezent në kërkesë padinë e paraqitur para Gjykatës, është pretenduar dhe tek Komisioneri.

Në objekt të kërkesë-padinë e depozituar pranë Gjykatës, me datë 26.04.2022, ankuesja ka kërkuar shprehimisht:

1. *“Shfuqizimin e aktit administrativ vendim nr. 3, datë 20.04.2022, për marrjen e masës disiplinore “Vërejtje”, si akt i paligjshëm.*
2. *Njoftimin e DAP për heqjen e shënimit të vërejtjes nga Regjistri Qendror i Personelit”.*

Komisioneri konstaton se, në parashtrimet e kërkesë padisë së bërë nga ankuesja pranë Gjykatës, ndër të tjera, në faqet 3-4 të saj, citohet se:

“... Kam rreth 6 muaj që diskriminohem nga eprorët e mi z. Q dhe z. K, të cilët në mënyrë të vazhdueshme më kanë vendosur në situata të pafavorshme në punë, duke mos më krijuar mundësinë e mjeteve minimale të punës dhe ngrohjes, duke më mbingarkuar me detyra, pasi drejtori ku unë punoj është minimalisht prej 6 muajsh me tri vende vakante, si dhe nga ana e eprorëve të mi është proceduar në shumë raste me akte administrative të paligjshme, urdhëra që bien ndesh me ligjin, për të cilat sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Administrative, nenit 43, kam njoftuar eprorin e eprorit që ka konkluduar me akt administrativ të paligjshëm, Ministrin e Drejtësisë.

Për këto arsye i jam drejtuar disa herë eprorëve të MD, duke kërkuar marrjen e masave ligjore lidhur me vendosjen e legjitimitetit, si dhe shfrytëzimin e akteve administrative. Situata me eprorët e mi është përkeqësuar edhe më tepër kur, kërkesa ime për lejen zyrtare të viti 2021, u refuzua tri herë pa shkak ligjor (i vetmi specialist që iu refuzuan pushimet e paguara të paezauruara të vitit paraardhës). Në mjaft raste i kam kërkuar eprorëve të mi eliminimin e praktikave të ndaluara dhe formave të diskriminimit, që nga nëntori i vitit 2021, si dhe kam vendosur në dijeni lidhur me këtë fakt edhe eprorët e eprorëve. Objekti i kësaj mase disiplinore ishte pikërisht mungesa ime nga institucioni ku jam e punësuar, për shkak se jam larguar nga DNJF në një takim pune në MD.

.....

Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi, i jep mundësinë palës që ndjehet e diskriminuar, të mos paraqitet në vendin e punës deri në eliminimin e kësaj praktike. Për këtë arsye prania ime në MD, edhe nëse nuk do të ishte pranuar nga eprori, nuk përbën arsye të pajustificueshme, por mund të përbëjë, në varësi të interpretimit të heshitjes së eprorit, shkelje të detyrimeve të përcaktuara në ligj.

Vlen të sjell në vëmendje të gjykatës, se kërkesa ime për eliminimin e diskriminimit i ishte bërë eprorëve të mi, në muajin nëntor 2021, dhe në mënyrë të vazhdueshme kam sjellë në vëmendje të eprorëve këtë fakt. Jo vetëm që nuk janë marrë masa nga eprorët për eliminimin e kësaj sjelljeje, por është thelluar edhe më tej.

.....

Masa “Vërejtje”, e marrë sipas rrethanës së pasqyruar në kërkesë-padi, është në kundërshtim flagrant me parimet e administrimit të shërbimit civil, sipas të cilave “Administrimi i shërbimit civil udhëhiqet nga ligji dhe bazohet në parimin e shanseve të barabarta, mosdiskriminimit, meritës, transparencës, profesionalizmit dhe paanësisë politike, si dhe garanton qëndrueshmërinë në detyrë të nëpunësit civil dhe vazhdimësinë e shërbimit civil”, dhe të drejtës

për proces të rregullt ligjor, në aspektet e së drejtës për t'u dëgjuar dhe të standardit të arsytimit të vendimit...

...Si pasojë e dhunës së vazhdueshme verbale, konfirmuar edhe nga emaili i datës 27.04.2022, ku eprorët më komunikojnë një shkresë të datës 09.04.2022, pas 16 ditësh, dhe formave të tjera arbitrare dhe provokuese, dhe për shkaqe të tjera, jam detyruar në datë 28.04.2022 të kërkoj pezullimin e statusit të nëpunësit civil, për shkak të frikës së një represioni tjetër të mundshëm, me dëm akoma edhe më të madh se dy vitet e parashkrimit të masës “Vërejtje”, dëmit ekonomik që më ka ardhur, dhe mbi të gjitha të pamundësisë që më shkaktohet për integrimin sërish në sistemin e nëpunësit civil, nga marrja e një mase të tillë dhe pezullimit për shkak të arbitraritetit të jashtëzakonshëm që kam hasur çdo ditë për 6 muaj”.

Në objekt të kërkesë-padisë drejtuar Gjykatës, ankuesja gjithashtu ka kërkuar marrjen e masave nga ana e DAP-it lidhur me heqjen e shënimit të masës disiplinore “Vërejtje” nga Regjistri Qendror i Personelit.

Bazuar në sa më sipër, subjekti ankues, në kërkesën e paraqitur pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, ka pretenduar *inter alia*, trajtimin e pafavorshëm dhe diskriminues në marrëdhëniet e punës, duke investuar kështu edhe Gjykatën për të njëjtat pretendime dhe shkak që ka sjellë paralelisht edhe pranë KMD-së.

Në Vendimin Unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nr. 03, datë 29.03.2012, i cili bën fjalë për objektin dhe shkakun ligjor të padisë, citohet:

“...Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë arrijnë në përfundimin se për të vlerësuar objektin e padisë është e nevojshme të shihet kërkesëpadia në përmbajtje të saj, të gjitha shtjellimet e kërkimet e paditësit dhe jo vetëm pjesa hyrëse e kërkesëpadisë. Natyrisht që palët kanë detyrimin që të paraqesin pretendime të qarta dhe të kuptueshme për palën tjetër dhe gjykatën, por jo domosdoshmërisht objekti i padisë gjendet gjithnjë vetëm në pjesën hyrëse të kërkesëpadisë (pavarësisht se në praktikë vërehet një konstante në këtë drejtim). Objekti i padisë përmbledh në vetvete të gjitha pretendimet e palës të parashtruara në aktin procedural të kërkesëpadisë. Ai mund të përmbajë një kërkim ose disa të tillë, ndaj kur vlerësohet se çfarë padie është paraqitur për gjykim, gjykatat nuk duhet të kufizohen vetëm tek pjesa hyrëse e kërkesëpadisë, por duhet të shohin tërësinë e përmbajtjes së saj. Kjo pasi zakonisht në pjesën hyrëse të kërkesëpadisë vendosen kërkimet bazë në formë të përmbledhur. Një pjesë e kërtimeve të padisë gjendet në pjesët përshkruese dhe shpjeguese të saj, e një pjesë tjetër mund të gjendet në pjesën fundore të kërkesëpadisë.”

Vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë janë një nga kategoritë e akteve me më ndikim në sistemin ligjor shqiptar dhe sidomos në praktikën gjyqësore. Përmes vendimeve unifikuese mundësohet interpretimi i njëzuar i ligjit, duke sjellë si pasojë zbatimin e njëzuar të tij në rastet

konkrete gjyqësore. Përmes vendimeve unifikuese jo vetëm garantohet shteti ligjor si themel kushtetues i Republikës, por i jepet jetë parimit të sigurisë juridike.

Neni 141, i Kushtetutës shprehet se: *“Për njësimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore, Gjykata e Lartë ka të drejtë të tërheqë për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara çështje të caktuara gjyqësore”*. Pra, Kushtetuta shprehimisht i njeh të drejtën dhe detyrimin Gjykatës së Lartë, që përmes Kolegjeve të Bashkuara të unifikojë, ose më saktë, të “njësojë” praktikën gjyqësore. Kjo kompetencë e Gjykatës së Lartë detajohet në ligjin nr. 9877/2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. (Në nenet 14, 16, 17 dhe 19 të të cilit parashikohet mënyra e ushtrimit të saj).

Ky Ligj, normon se: *“Moszbatimi i vendimeve unifikuese, si dhe i vendimeve të tjera të Gjykatës së Lartë, kur, sipas kodeve të procedurave këto vendime janë të detyrueshme përbën shkelje të rëndë disiplinore”*. Për rrjedhojë, të gjitha vendimet unifikuese janë të detyrueshme për gjykatat dhe moszbatimi i tyre sjell përgjegjësi disiplinore, me pasojë shkarkimin nga detyra të gjyqtarit.

Juridiksioni gjyqësor është i ndarë nga ai administrativ, por aktet e këtij të fundit janë objekt kontrolli nga gjykata administrative, e cila vendos përfundimisht për çështjen. Në rastin e ankuesit, të njëjtat fakte, rrethana, parashtrime, janë bërë objekt shqyrtimi si në juridiksionin administrativ dhe atë gjyqësor.

Në këtë kontekst, në kushtet që kjo çështje është duke u gjykuar nga Gjykata, bazuar në paragrafin 3, të nenit 36, të Kodit të Procedurës Civile, ku parashikohet se:

“...Asnjë institucion tjetër nuk ka të drejtë të pranojë për shqyrtim një mosmarrëveshje civile që është duke u gjykuar nga gjykata...”, si dhe në nenin 33, pikën 7/4 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet se: *“Kur Komisioneri vihet në dijeni se ankuesi ka paraqitur kërkesë padi në gjykatë me objekt konstatim diskriminimi, ndërkohë që ka paraqitur të njëjtën ankesë pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe çështja është në shqyrtim e sipër, Komisioneri merr vendim për pushimin e çështjes”,* Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi nuk mund të shprehet, lidhur me ankesën nr. 70 Regj., datë 26.04.2022, të shtetases E. Z, dhe deklaron pushimin e shqyrtimit të saj⁶.

Bazuar në nenin 36, pika 4, të ligjit nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet shprehimisht se:

“Gjykata mund t’i kërkojë Komisionerit, në çdo fazë të procedimit, që të paraqesë një mendim me shkrim, rezultatet e hetimit të tij, në qoftë se është bërë hetimi, ose çdo informacion tjetër që

⁶ Për analogji citojmë vendimet me: nr. 13, datë 28.01.2021, nr. 27, datë 16.02.2021, nr. 77, datë 07.05.2021, nr. 230, datë 25.11.2021, nr. 253, datë 28.12.2021, nr. 77, datë 21.04.2022, të Komisionerit.

ka rëndësi për çështjen”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në rastin kur Gjykata e kërkon atë⁷, përgatit dhe paraqet mendimin me shkrim, lidhur me çështjen sa më sipër.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 36 të ligjit nr. 8116, datë 29.03.1996 “*Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar, si dhe referuar nenit 32, pika 1, germa a), nenit 33, pika 7/4, dhe nenit 36/4, të ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Pushimin e shqyrtimit të ankesës nr. 70 Regj., datë 26.04.2022, të paraqitur nga shtetasja E. Z, për shkak se çështja është duke u gjykuar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Fusha: Punësim
Shkaku: Çdo shkak tjetër
Lloji i vendimit: Pushim/Gjykatë

⁷ Ose me kërkesë drejtuar Gjykatës, të palës së interesuar në procesin gjyqësor të iniciuar.